



Miratur me vendim të AMA nr. 76 datë 04.04.2016

RREGULLORE

PËR TRANSMETIMIN PA SHPËRBLIM TË INFORMACIONEVE, MESAZHEVE DHE NJOFTIMEVE ME INTERES TË LARTË PËR PUBLIKUN E GJERË

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të përcaktojë llojin dhe tipologjinë e informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve që konsiderohen se paraqesin interes të lartë për publikun e gjerë, subjektet që emetojnë këtë lloj informacioni si dhe kushtet e transmetimit nga ana e ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe audioviziv.
2. Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e OSHMA-ve në kuadër të përmbushjes së detyrimit ligjor të transmetimit pa shpërblim të informacionit me interes të lartë, si dhe të gjithë palëve të interesuara në publikimin e mesazheve të tilla.

Neni 2 Baza ligjore

1. Kjo rregullore është përgatitur në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
2. Kjo rregullore mban parasysh edhe aktet nënligjore të institucioneve të tjera që lidhen me përcaktimin e ngjarjeve dhe situatave, prej të cilave lind domosdoshmëria e transmetimit të informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve që paraqesin interes të lartë për publikun e gjerë.

Neni 3 Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe direktivën e Bashkimit Europian për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD) 2010/13/EU.



Neni 4

Parimet e transmetimit të informacioneve pa shpërblim

Transmetimi pa shpërblim i informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve me interes të lartë për publikun e gjerë:

- a) duhet të garantojë lirinë e shprehjes dhe të drejtën e informimit;
- b) duhet të respektojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar;
- c) duhet të respektojë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut;
- d) nuk duhet të nxisin intolerancën ose të justifikojnë dhunën;
- e) duhet të respektojë të drejtën e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- f) nuk duhet të përmbajnë mesazhe të dëmshme, nxitje të krimit, dhunës fizike apo urrejtjes;
- g) nuk duhet të kenë asnjë nuancë politike;
- h) nuk duhet të përdoren për qëllime politike.

KREU II

MESAZHET ME INTERES TË LARTË PËR PUBLIKUN E GJERË

Neni 5

Informacionet, mesazhet dhe njoftimet me interes të lartë për publikun e gjerë

Informacionet, mesazhet dhe njoftimet me interes të lartë për publikun e gjerë të cilat emetohen nga OSHMA-të pa shpërblim, konsiderohen ato përmbajtje të cilat synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve, të ndryshojnë qëndrimet dhe sjelljet e tyre në çështje me ndjeshmëri sociale, si dhe që lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare. Këto përmbajtje nuk krijojnë në asnjë rast përfitim financiar për institucionet në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, të cilat janë porositës të tyre.

Neni 6

Mesazhet e organeve të pushtetit qendror

Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), janë të detyruar të transmetojnë pa shpërblim:

- 1. Njoftime dhe mesazhe të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Kuvendit të Shqipërisë, që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, paqen dhe integritetin e vendit.
- 2. Mesazhe, njoftime dhe informacione të Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe Ministrisë së Mbrojtjes që lidhen me mbrojtjen e vendit dhe jetës së



popullsisë nga sulmet e mundshme terroriste dhe njoftime të tjera të ngjashme me to.

3. Njoftime, komunikata dhe informacione të Ministrisë së Punëve të Brendshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ruajtjen e rendit publik dhe sigurinë e popullsisë, qarkullimin në rrugë të automjeteve, kufizimet e përkohshme, për interes të lartë publik, në plotësimin e nevojave jetike të popullsisë, si dhe në rastet e përballimit të fatkeqësive natyrore, kur këto mesazhe janë me interes kombëtar, ose përfshijnë zona dhe objekte të veçanta të konsideruara pasuri kombëtare.
4. Informacione, mesazhe, thirrje të Ministrisë së Shëndetësisë, që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të popullsisë në një situatë të jashtëzakonshme, për rastet e epidemive e sëmundjeve ngjitëse, që përhapen shpejt dhe përbëjnë rrezik për komunitetin, si dhe mesazhet që lidhen me dhurimin vullnetar e falas të gjakut.
5. Njoftime dhe mesazhe të Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive që kanë për synim paralajmërimin dhe sensibilizimin e opinionit publik për zhvillimin e ngjarjeve me interes të lartë për publikun e gjerë.

Neni 7

Mesazhet e organeve të pushtetit vendor

Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA) që ushtrojnë veprimtari audiovizive në zonat lokale, janë të detyruar të transmetojnë pa shpërblim mesazhe ose njoftime të shkurtra të organeve qeverisëse të pushtetit vendor dhe të administratës shtetërore vendore, të ngjashme me pikat 3, dhe 4 të nenit 6 të kësaj Rregulloreje, si dhe ato që lidhen me zhvillime e ngjarje të papritura që çenojnë rendin dhe sigurinë e qytetarëve në zona e rajone të ndryshme të vendit.

Neni 8

Mesazhe të tjera

Ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), janë të detyruar të transmetojnë pa shpërblim:

1. Njoftime e komunikata të organizmave *ad hoc*, të krijuara me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, në rastet e përballimit të fatkeqësive natyrore, si tërmete, përmytje, zjarre, thatësira, rrëshqitje toke, bllokim i papritur i komunikacionit, kur këto mesazhe janë me interes kombëtar, ose përfshijnë zona dhe objekte të veçanta të konsideruara pasuri kombëtare.
2. Informacione, mesazhe e njoftime të organizatave të ndryshme jofitimprurëse për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, vetëm pas konfirmimit të dhënë me shkrim nga AMA për llojin e mesazhit.



KREU III

KUSHTET E TRANSMETIMIT TË MESAZHEVE ME INTERES TË LARTË PËR PUBLIKUN E GJERË

Neni 9

Kushtet e përgjithshme të transmetimit

1. Kohëzgjatja e informacionit, mesazhit dhe njoftimit me interes të lartë për publikun e gjerë nuk mund të jetë më e gjatë se 90 sekonda.
2. Transmetimi i informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve me interes të lartë për publikun e gjerë duhet të bëhet në fashat orare më të ndjekura nga shikuesit dhe dëgjuesit.
3. Transmetimi i informacionit të sipërcituar mund të bëhet brenda apo jashtë edicioneve informative.

Neni 10

Përrjashtime

1. Në raste emergjente, kur përmbajtja e informacioneve, mesazheve dhe njoftimeve me interes të lartë për publikun e gjerë kërkon marrjen e masave të menjëhershme, OSHMA-të duhet t'i transmetojnë ato menjëherë, duke ndërprerë programet në vijim.
2. Informacionet, mesazhet dhe njoftimet me interes të lartë për publikun e gjerë mund të emetohen edhe përmes titrave në ekran, kur për këtë kanë rënë dakord porositësi me OSHMA-në.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e OSHMA-ve në transmetimin e mesazheve me interes të lartë për publikun e gjerë

1. OSHMA-të kanë detyrimin që t'i transmetojnë pa shpërblim mesazhet me interes të lartë për publikun e gjerë.
2. OSHMA-të nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e mesazheve të cituara më sipër, përveç në rastet kur ato ndryshohen prej tyre për qëllime të caktuara.

KREU IV

SANKSIONET

Neni 12

1. Shkelja e parashikimeve urdhëruese të kësaj rregulloreje konsiderohet si mosrespektim i kohës së përcaktuar për transmetim, sipas kushteve të licencës dhe sanksionohet në bazë të ligjit Nr. 97/2013 "Për mediat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, neni 133/2 dhe akteve nënligjore të miratuar nga AMA në dhe për zbatim të tij.

2. AMA, në vendimin e saj, merr në konsideratë masën e mosrespektimit të parashikimeve urdhëruese të kësaj rregulloreje dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13
Publikimi

Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj, publikohet në faqen zyrtare të AMA-s në internet, pas miratimit të saj.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga AMA.